



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

për vizitat në stacionet policore në vijim:

1. Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë, stacioni “Qendër”
2. Stacioni Policor në Lipjan
3. Stacioni Policor në Podujevë
4. Stacioni Policor në Mitrovicë
5. Stacioni Policor në Vushtrri
6. Stacioni Policor në Prizren
7. Stacioni Policor në Suharekë
8. Stacioni Policor në Dragash

Për: Z. Flamur Sefaj, Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme
Z. Shpend Maxhuni, Drejtor i Përgjithshëm
Policia e Kosovës

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm MKPT) i Avokatit të Popullit ka vizituar stacionet policore të lartpërmendura.

Prishtinë, më 18 dhjetor 2017

Datat e vizitave dhe përbërja e grupit monitorues

1. Stacionet e lartpërmendura policore janë vizituar nga MKPT në datat si në vijim:
 1. Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë, stacioni “Qendër”, 30 tetor 2017
 2. Stacioni Policor në Lipjan, 9 tetor 2017.
 3. Stacioni Policor në Podujevë, 18 tetor 2017.
 4. Stacioni Policor në Mitrovicë, 19 tetor 2017.
 5. Stacioni Policor në Vushtrri, 19 tetor 2017.
 6. Stacioni Policor në Prizren, 27 tetor 2017.
 7. Stacioni Policor në Suharekë, 27 tetor 2017.
 8. Stacioni Policor në Dragash, 27 tetor 2017.
2. Grupi monitorues përbëhej nga një juristë, një psikologe dhe një mjek.

Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës

3. Gjatë vizitës në stacionet e lartpërmendura, Policia e Kosovës i ofroi MKPT bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat. Ekipit i u siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe qasja në të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe iu mundësua intervistimi i personave të arrestuar pa prezencë të zyrtarëve policor.
4. Sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, personat e dyshuar për kryerje të veprës penale mund të mbahen nga policia deri në 48 orë para se të dërgohen para gjyqtarit të procedurës paraprake. Policia mund të mbaj dhe të mbledhë informata nga personat të cilët gjenden në vendin ku është kryer vepra penale të cilët mund të sigurojnë informata relevante (periudha maksimale kohore: gjashtë orë)¹.

Garancitë kundër keqtrajtimit

5. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm “KPT”), në raportin e 2-të të përgjithshëm të publikuar në vitin 1992 ka theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia për të njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin e tij (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën), e drejta për të pasur një avokat, e drejta për t’u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritet policore).²
6. Këto të drejta duhet të zbatohen jo vetëm në rastin e personave të ndaluar por edhe në rastet tjera kur qytetarët detyrohen të qëndrojnë në polici apo me policinë edhe për arsye tjera (për shembull, për qëllime identifikimi).
7. Sipas KPT, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i parë i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përshkruhet në kuadër të sistemi ligjor.
8. Po ashtu, këto të drejta themelore parashihen edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Policinë.³

¹ Nenet 162, 163, 164 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

² Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f> (15.11.2017).

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 29 dhe 30. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 13. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës,

9. Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë në gjuhën të cilin ai/ajo e kupton për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për të njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër për faktin se është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.⁴
10. Sa i përket njoftimit për arrestin, neni 168 i Kodit të Procedurës Penale më tej përcakton se personi i arrestuar ka të drejtë të njoftojë anëtarin e familjes apo personin tjetër sipas përzgjedhjes së tij për arrestin dhe vendin e ndalimit menjëherë pas arrestimit; njoftimi i familjarit apo personit tjetër lidhur me arrestimin mund të vonohet më së shumti deri në 24 orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetim të rastit. Kjo vonesë nuk aplikohet në rastin e personave të mitur.
11. Sipas Ligjit për Policinë⁵ e drejta për të njoftuar familjen apo personin tjetër për arrestimin gjithashtu vlen edhe për personat të cilët janë në “ndalim të përkohshëm” me qëllim të identifikimit ose për shkak të mbrojtjes së tyre dhe mbrojtjes së të tjerëve.
12. Gjatë vizitave, MKPT është njoftuar nga zyrtarët policor se gjatë intervistimit të personave të arrestuar nuk praktikohet audio-video incizimi i intervistave. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT) konsideron se:
*“Regjistrimi elektronik (audio dhe/ose video) i intervistave policore përbën një garanci të rëndësishme shtesë kundër keqtrajtit të të arrestuarve. KPT ka kënaqësinë të vërejë se vënia në përdorim e sistemeve të tilla po shqyrtohet nga një numër i vendeve. Një sistem i tillë mund të sigurojë një proces të intervistimit të kompletuar dhe autentik dhe në këtë mënyrë lehtëson shumë hetimin e çdo pohimi për keqtrajtim. Kjo është në interes të dy palëve, respektivisht të personave të cilët janë keqtrajtuar nga policia dhe në interes të zyrtarëve policor të cilët përballën me pohime të pabazuara se janë përfshirë në keqtrajtim fizik dhe presion psikologjik. Po ashtu, regjistrimi elektronik e zvogëlon mundësinë e të pandehurve që më vonë rrejshëm të mohojnë se ata kanë bërë pohime të caktuara”.*⁶
13. Në raportin për vizitën e Irlandë në vitin 2006, KPT thekson:
“Të gjeturat gjatë vizitës në vitin 2006, sugjerojnë se audio-video incizimet në dhomat e intervistimit në stacionet e Garda, mund të kenë qenë faktor domethënës që ka kontribuar në zvogëlimin e pohimeve për keqtrajtim fizik të personave të arrestuar”.
14. **MKPT e Avokatit të Popullit inkurajon Policinë e Kosovës që të shqyrtojë mundësinë e zbatimit të një sistemi të tillë të audio dhe video incizimeve në pajtim me konstatimet e KPT-së dhe për këtë të njoftojë Avokatin e Popullit.**
15. MKPT ka vërejtur se në stacionet policore të vizituara, kamerat e sigurisë janë operacionale në hapësirat e stacioneve dhe në qelitë ku mbahen të arrestuarit, **përveç në stacionin policor në Lipjan.**
16. **MKPT nuk ka pranuar ankesa nga personat e arrestuar të cilët gjendeshin në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë lidhur me këto të drejta. Po ashtu, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar del se Policia e Kosovës në të gjitha**

⁴ Shih po ashtu nenet 29 dhe 30 të Kushtetutës.

⁵ Ligji për Policinë, neni 20.

⁶ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, ekstrakt nga raporti i 12 i përgjithshëm, paragrafi 36. Për më shumë shih: <https://rm.coe.int/16806cd1ed> (24.11.2017).

stacionet e vizituara ka respektuar këto të drejta. Gjatë vizitave, MKPT ka vërejtur se në secilën qeli ndodheshin informata të shkruara lidhur me të drejtat e personave të arrestuar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Gjatë vizitave, MKPT nuk ka hasur në të mitur të arrestuar.

Kushtet fizike të stacioneve policore të vizituara

17. **Në Stacionin Policor në Lipjan** qelitë ku mbahen personat e arrestuar ofrojnë kushte të mira akomodimi, përfshirë dritën e mjaftueshme natyrale, pastërti, ventilim. Ndërsa, madhësitë e qelive janë në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT.
18. **Qendra e Rajonale e mbajtjes në Prishtinë** është rinovuar gjatë vitit 2016. MKPT ka vërejtur se qelitë ishin të pastra, hapësira për person në qeli është në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT⁷, secila qeli kishte dyshek dhe çarçaf të pastër, por kishte shumë pak dritë natyrale dhe qelitë nuk ishin të pajisura me sistem të thirrjes. Brenda Qendrës funksiononte sistemi i ventilimit. Tualetet dhe dushet ishin në gjendje të mirë dhe kishte edhe ujë të ngrohtë.
19. Ashtu si edhe gjatë vizitës në këtë qendër në vitin 2016, MKPT ka vërejtur se kushtet për punë të zyrtarëve policorë të cilët punonin në këtë Qendër nuk ishin të mira dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim. **MKPT konsideron se autoritet relevante duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për evitimin e këtyre mangësive.**
20. **Stacioni Policor në Mitrovicë** është në gjendje shumë të mirë. Qendra e Mbajtjes ofron kushte shumë të mira të akomodimit dhe hapësirë në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT. Po ashtu, hapësirat e stacionit policor ofrojnë kushte të mira për punën e zyrtarëve policor.
21. **Stacioni Policor në Vushtrri** gjatë vizitës së MKPT ishte duke u rinovuar. Dhomat e mbajtjes ofrojnë kushte akomodimi dhe hapësirë në pajtime me standardet e përcaktuara nga KPT. Për shkak të rinovimit, kushtet për punë të zyrtarëve policor ishin vështirësuar. MKPT do të kërkojë nga Ministria e Punëve të Brendshme të njoftohet lidhur rinovimin në fjalë.
22. **Stacioni Policor në Podujevë** ofron kushte të akomodimit dhe hapësirë në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT. Të gjitha qelitë ofrojnë dritë të mjaftueshme natyrale, ventilim të duhur, tualete dhe çarçafë të pastër. Ndërtesa posedon shkallët për dalje emergjente në rast nevojë.
23. **Në Stacioni Policor në Suharekë** qelitë ku akomodohen të arrestuarit ofrojnë ndriçim natyral të mjaftueshëm, ventilim të duhur dhe madhësia e qelive është në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT. Po ashtu, ky stacion ofron kushte dhe hapësirë përgjithësisht të mira për punë të zyrtarët policor.
24. **Në Stacioni Policor në Prizren** MKPT ka vërejtur se qelitë ku akomodohen të arrestuarit janë në gjendje të keqe dhe duhet të gëlqerosen (lyhen), si dhe të furnizohen me çarçafë dhe batanije të pastra meqenëse ato ekzistueset janë të vjetra dhe as për së afërmi nuk i plotësojnë kushtet për akomodim të të arrestuarve në pajtim me standardet ndërkombëtare. Ky stacion, përgjithësisht ofron kushte të mira për punë të zyrtarëve policor.
25. **Stacioni Policor në Dragash** është rinovuar komplet dhe ofron kushte të mira për punë të zyrtarëve policor. Qelitë ku akomodohen personat e arrestuar janë në gjendje shumë të mirë, posedojnë ndriçim të mjaftueshëm natyral, ventilim dhe madhësia e

⁷ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f> (15.11.2017).

tyre është në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT. Ky stacion posedon dhomën e intervistimit për të mitur dhe atë për intervistim në rastet e dhunës në familje. MKPT gjatë vizitës u impresionua nga kushtet e mira të cilat i ofron dhoma ku intervistohen viktimat e dhunës në familje e cila ofronte kushte shumë të mira dhe ishte adekuate për viktimat të cilat aty vendosen së bashku me fëmijët.

Sistemi i thirrjes

26. **Asnjëra nga stacione e vizituara nuk posedon sistem të thirrjes.** MKPT vëren se KPT në raportet për Kosovën për vizitën në vitin 2015 u ka rekomanduar autoriteteve kompetente në Kosovë që qelitë në stacionet policore të pajisen me sistem të thirrjes gjë që të arrestuarve do t'u mundësonte kontakt më të lehtë me zyrtarët policor në rast nevojë. Autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës, lidhur me këtë raport KPT-së i dërguan përgjigjet e tyre, por pjesa ku do të duhej të përgjigjeshin lidhur me sistemin e thirrjeve në qeli është e thatë, pra nuk ka përgjigje fare.⁸

Regjimi


27. Në raportin e 12-të të përgjithshëm të publikuar në vitin 2002, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës thekson se personave të cilët mbahen në arrest në polici më shumë se 24 orë duhet që brenda mundësive tu ofrohet ajrosje ditore.⁹ **MKPT u njoftua nga zyrtarët policor se Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë dhe stacionet tjera të vizituara nuk ofrojnë ajrosje për personat e arrestuar të cilët qëndrojnë më shumë se 24 orë në mbajtje pasi që nuk posedojnë kushte fizike.**

Kujdesi shëndetësorë

28. Shërbimet mjekësore janë e drejtë themelore e personave të cilët arrestohen nga policia. Shërbimet mjekësore ofrohen nga institucionet publike siç janë Qendra e Mjekësisë Familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim. **MKPT nuk ka pranuar ankesa nga personat e intervistuar lidhur me këtë të drejtë. Po ashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar është vërejtur se policia ka evidentuar në dosjet e tyre personale njoftimin për të drejtën për të pasur shërbime mjekësore.**
29. MKPT ka vërejtur se të gjitha të dhënat lidhur me shërbimet e ofruara mjekësore ndaj të arrestuarve mbahen në dosjen e tij/saj personale.

Rekomandimet lidhur me vizitat në Stacionet e lartpërmendura Policore do t'u dërgohet institucioneve të lartpërmendura në muajin janar 2018.

Me nderime,


Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

⁸ Raporti i KPT për vizitën në Kosovë në vitin 2015, përgjigja e autoriteteve. Shih në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo> (29.11.2017).

⁹ Raporti i 12-të i Përgjithshëm i KPT, paragrafi 47, në: <https://rm.coe.int/16806cd1ed> (29.11.2017).